



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:191424

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05285464

P.nr.1154/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Amar Hoxha, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.S., nga Prizreni, për shkak të dy veprave penale dhe atë: veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar. 1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar. 1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1786-4/2022 të datës 02.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, avokat V.Sh., më datë 30.11.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.S., nga i ati dhe nëna, e lindur, i lindur më datënë fshatin Brodosan, Komuna Dragash, tani me banim në Prizren, në rrugën “.....”, pa numër, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal,

ËSHTË FAJTOR

Sepse

I. Me datë 13.09.2022 , rreth orës 20:00 min, në Prizren, në rrugën “Ekrem Rexha”, pikërisht në dyqanin “.....” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër – të dëmtuarit “.....” telefonin mobile “.....+” me vlerë prej 999 euro, në atë mënyrë shfrytëzon momentin volitshëm pa u vërejtur nga punëtorë e dyqanit, **mënjanon pengesat, me forcë largon nga kufja dhe kabllot** telefonin mobil të llojit të lartcekur dhe ik nga vendi ngjarjes pa u vërejtur nga punëtorët prezent.

- Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 paragr. 1, nënpar. 1.1 të KPRK.

II. Me datë 14.09.2022, rreth orës 20:00 min, në Prizren, në rrugën “Ekrem Rexha”, pikërisht në dyqanin “.....” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër – të dëmtuarit “.....” telefonin mobile “Iphone13 me vlerë prej 1349 euro, në atë mënyrë shfrytëzon momentin volitshëm pa u vërejtur nga punëtorë e dyqanit, **mënjanon pengesat, me forcë largon nga kufja dhe kabllot** telefonin mobil të llojit të lartcekur dhe ik nga vendi ngjarjes pa u vërejtur nga punëtorët prezent.

- Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 paragr. 1 nënpar. 1.1 të KPRK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38, 39 par.1, nënpar.1.1, 40 par.1, nënpar.1.2, 42, 69, 70, 71 par.1, nënpar.1.3, 72 par.1, nënpar.1.3, si dhe nenit 315 par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

Për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1, nënpar. 1.1 të KPRK-së, të përshkruar më gjerësisht në pikën I të dispozitivit të aktakuzës

- Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, si dhe
- Dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

Për veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1, nënpar. 1.1 të KPRK-së, të përshkruar më gjerësisht në pikën II të dispozitivit të aktakuzës

- Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, si dhe
- Dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro.

Konform nenit 76 par.1 dhe par.2, nënpar. 2.2 të akuzuarit i shqipton **DËNIM UNIK dhe atë**

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim do t’i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 18.09.2022 deri më datën 30.11.2022, gjegjësisht koha prej 74 (shtatëdhjetë e katër) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej gjashtëqind (600) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e në rast se i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet apo dënim i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të dënimit me gjobë do të llogaritet nga 1 (një) ditë burgim, respektivisht 30 (tridhjetë) ditë burgim.

Ndaj të akuzuarit E.S., në kuptim të nenit 87 par.1, nënpar.1.2 dhe nenit 3 dhe 5 të KPRK-së, shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES

CAKTOHET masa e trajtimit me rehabilitim të detyrueshën të personave të varur nga droga ose alkooli dhe atë në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, ashtu që i akuzuari obligohet që çdo 30 (tridhjetë) ditë të paraqitet pranë qendrës për trajtim dhe rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli dhe atë në kohëzgjatje deri në përfundimin e dënimit plotësues.

Rehabilitimi i detyrueshëm ndaj personave të varur nga droga ose alkooli do të mbikëqyret nga ana e Repartit të Psikiatrisë të Spitalit Regjional në Prizren “Dr. Daut Mustafa”, të cilët obligohen konform dispozitave ligjore ta njoftojnë gjykatën lidhur me respektimin e dënimit plotësues ndaj të akuzuarit, po ashtu obligohet institucioni i lart cekur që gjykatën ta njoftojë me shkrim çdo 30 (tridhjetë) ditë lidhur me vijueshmërinë e paraqitjes të akuzuarit pranë institucionit të Repartit të Psikiatrisë të Spitalit Regjional në Prizren “Dr. Daut Mustafa”.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të mbrojtjes së viktimave të paguajë shumën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

E dëmtuara “.....” në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtuar aktakuzën PP/II.nr.1786-4/22 të datës 02.11.2022, kundër të akuzuarit E.S., nga Prizreni, për shkak të veprave penale dhe atë: veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar. 1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar. 1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Prokurori i shtetit Besim Susuri, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP/II.nr.1786-4/22 të datës 02.11.2022, kundër të akuzuarit E.S., nga Prizreni, për shkak të veprave penale dhe atë veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 pika 1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK) të përshkruar më gjerësisht nën pikën I të dispozitivit të aktakuzës dhe veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 pika 1.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK) të përshkruar më gjerësisht nën pikën II të dispozitivit të aktakuzës, dhe i propozoj gjykatës që me faktin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit E.S., në tërësi vërtetohet gjendja faktike e përshkruar më për së afërmi si në dispozitivet nën I dhe II të aktakuzës, me këtë vërtetohet fakti se i akuzuari me këtë ka kryer veprat penale vjedhja e rëndë neni 315 par.1 nënpar.1.1 më datë 13.09.2022 si dhe për herë të dytë në intervalin kohor shumë të shkurtër që në literaturë mund të thuhet se kemi të bëjmë me vepër penale në vazhdimësi pasi që i njëjti prapë më datë 14.09.2022 ka kryer veprën penale të njëjtë, pra të vjedhjes së rëndë neni 315 par.1 nënpar.1.1, dhe atë ndaj të dëmtuarit të njëjtë "A....." në Prizren në të dy rastet. Kërkoj nga gjykata që i

pandehuri për këto vepra penale të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, gjithashtu në kuptim të nenit 87 par.1, nënpar.1.2 të KPRK-së propozoj që të pandehurit E.S., t'i caktohet masa e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli në institucionet përkatëse, pasi që nga pohimi edhe i vet të pandehurit i njëjti ka theksuar faktin se që të dyja veprat penale i ka kryer nën ndikim të substancave narkotike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. V.Sh., në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar: ne si mbrojtje me vet pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, sa i përket gjendjes faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës nuk kemi tjetër çka të shtojmë.

Por i propozojmë gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese në dobi të të mbrojturit tim dhe atë të nenit 70 par.1 pika 1.3 si dhe nenit 71 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3, të gjitha këto rrethana të cekura më lart i propozoj gjykatës që t'i marrë si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Të dhënat e lart cekura në mbrojtjen e të mbrojturit tim i theksoj nga vet fakti se edhe vet i mbrojturi im në deklaratën e tij thekson se ka qenë përdorues i kohëpaskohshëm i substancave narkotike, psikotrope dhe analoge, të cilat veprime nga përdorimi i të njëjtave, i njëjti nuk ka mundur të kuptojë pasojën e shkaktuar me veprimet e tij, po ashtu tek i njëjti pas konsultimeve paraprake kemi gjetur se i njëjti në bashkëpunim me anëtarët e familjes ës tij të cilët e përkrahin dhe e mbështesin do të vazhdojë shërimin nga kjo varësi, dhe t'i kthehet shoqërisë si qytetar i dobishëm i saj.

Tek i akuzuari, këtu i mbrojturi im është konstatuar dhe pendimi i tij i thellë për veprimet e tij, premtimi i tij se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla, veprime këto që i ka kryer nën ndikimin e substancave narkotike, e me të kuptuar pasojat e veprimeve të tij, respektivisht përvetësimin e sendeve të huaja, të njëjtat ia ka kthyer të dëmtuarës.

Po ashtu jemi të pajtimit si mbrojtje edhe me propozimin e Prokurorit të Shtetit që ndaj këtu të mbrojturit tim të shqiptohet edhe masa e trajtimit me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli në institucionet përkatëse.

I akuzuari E.S., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: në tërësi pajtohem me fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe i propozoj gjykatës që të gjitha të cekurat më lart dhe atë pranimin e fajësisë nga ana ime, pendimin tim të thellë për veprën e kryer si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana i propozoj gjykatës që t'i marrë si rrethana lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Në fund i propozoj gjykatës që në ditën e sotme të ndërpritet masa e paraburgimit ndaj meje e caktuar dhe e vazhduar nga ana e kësaj gjykate, pasi që konsideroj se me ditën e sotme kanë pushuar të gjitha kushtet dhe rrethanat për të cilat është caktuar paraprakisht si dhe është vazhduar e njëjta.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

I. Me datë 13.09.2022 , rreth orës 20:00 min, në Prizren, në rrugën “Ekrem Rexha”, pikërisht në dyqanin “A.....” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për

personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër – të dëmtuarit “A.....” telefonin mobile “ONE+” me vlerë prej 999 euro, në atë mënyrë shfrytëzon momentin volitshëm pa u vërejtur nga punëtorë e dyqanit, **mënjanon pengesat, me forcë largon nga kufja dhe kabllot** telefonin mobil të llojit të lartcekur dhe ik nga vendi ngjarjes pa u vërejtur nga punëtorët prezent.

II. Me datë 14.09.2022 , rreth orës 20:00 min, në Prizren, në rrugën “Ekrem Rexha”, pikërisht në dyqanin “A.....” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër – të dëmtuarit “A.....” telefonin mobile “Iphone13 me vlerë prej 1349 euro, në atë mënyrë shfrytëzon momentin volitshëm pa u vërejtur nga punëtorë e dyqanit, **mënjanon pengesat, me forcë largon nga kufja dhe kabllot** telefonin mobil të llojit të lartcekur dhe ik nga vendi ngjarjes pa u vërejtur nga punëtorët prezent.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale të cilat i vihen në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e dy veprave penale dhe atë: të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar. 1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të përshkruar më gjerësisht nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dhe veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar. 1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). të përshkruar më gjerësisht nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform nenit 70 të KPRK-së, gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, moshja e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas rastit, konform nenit 71 par.1, nënpar.1.3 dhe nenit 72 par.1, nënpar.1.3, gjykata i shqiptoi të akuzuarit dënim nën kufirin e paraparë me ligj, pasi që i njëjti pranoi fajësinë për të dy veprat penale të cilat i viheshin në barrë, andaj gjykata nga të cekurat i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti për veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, të përshkruar më gjerësisht në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit dhe dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti për veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, të përshkruar më gjerësisht në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, andaj duke vepruar konform nenit 76 par.1 dhe par.2, nënpar. 2.2 të akuzuarit i shqiptoi dënim unik dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashhtë) muajve, në të cilin dënim ka llogaritur edhe kohën e kaluar në masën e paraburgimit

prej datës 18.09.2022 deri më datën 30.11.2022, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civilo-juridik, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPPRK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 36 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të cekurat më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL
P.nr.1154/2022 më datë 30.11.2022

Procesmbajtësi
Amar Hoxha
Berisha

Gjyqtari
Luan

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.